



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

Nr. 5255 Prot

Vau Dejës, më 17.07.2026

Lënda: Kërkesë për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi.

KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimin për "Miratimin e tavaneve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 për Bashkinë Vau Dejës".

Duke ju uruar punë të mbarë!

Konceptoi:
Armena Zagani

Miratoi:
Elsa Tanushi

KRYETAR

Kristian SHKRELI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETAR

PROJEKT-VENDIM

Nr. 11, datë 17.07.2026

PËR

**“MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2027-2029 PËR BASHKINË VAU DEJËS”.**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës _____, 2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3, neni 34 dhe 41 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; neni 37 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV”; VKB Vau Dejës nr 75 datë 23.12.2025 “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe Buxhetit vjetor 2027”, Udhëzimit nr 7 datë 27.02.2026 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029” dhe sipas Udhëzimit Plotësues nr 17 datë 10.07.2026 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2027-2029” dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës ,

V E N D O S I:

1. Të miratojë tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm për vitet 2027 - 2029, të Bashkisë Vau Dejës, sipas relacionit shpjegues për procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (sipas shtojcës 2, Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029) bashkëlidhur dokumentat e gjeneruar nga Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV), si më poshtë:
 - i. Raporti PBA 1: Tavanet e PBA sipas programeve
 - ii. Raporti PBA 2: Parashikimi i të ardhurave
 - iii. Raporti PBA 3: Shpenzimet e NJQV dhe Programit dhe Klasifikimit Ekonomik
 - iv. Raporti PBA 4: Shpenzimet e NJQV sipas Klasifikimit funksional (niveli I, II, III i COFOG)
 - v. Raporti PBA 5: Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik
 - vi. Raporti PBA 6: Deklarata e Politikës sipas Programeve
 - vii. Raporti PBA 7: Shpenzimet e Produkteve sipas Programeve
 - viii. Raporti PBA 8: Projektet e Investimeve
 - ix. Raporti PBA 9: Informacion mbi të dhënat e programit
 - x.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kristian SHKRELLI



Zv. Kryetar

Elvis Jregi

Zv. Kryetar

Aleksandra Gjoni

Drejtorja Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Ela Ruzhica

Drejtorja e Burimeve Njerëzore

Xhuana Hardoda

Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes Konsumatorit dhe Veterinarisë

Besmir Jem

Drejtorja Planifikimit të territorit, Kadastrës dhe investimeve Publike

Edmir Abdije

Drejtorja e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social

Ridvan Luzaku

Drejtorja Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile

Emal Zaganjari

Zv. Kryetar

Ervis Mollo

Drejtorja Juridike Prokurimeve dhe Aseteve

Harmon Dudo

Policia Bashkiake

Georgi Dusha

Drejtorja e Menaxhimit të Pyjeve, Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Fehri Shkijaku

Drejtorja e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Zhvillimit të Turizmit

Delir Vaci

Drejtorja Informimit Publik, Medias, dhe IT-së

Mark Zhurri

Drejtorja e Integritimit Europian Projekteve dhe Performances

Mark Zhurri

TAVANET PËRFUNDIMTARE TË PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2027-2029

[illegible]

Konceptoi:
Armena Zagani

Miratoi:
Elsa Tanushi

KRYETAR

Kristian SHKRELI



SHTOJCA 2

Struktura e Dokumentit së Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor, 2027-2029



BASHKIA VAU DEJËS

PROJEKT DOKUMENTI

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029

Korrik 2026

PËRMBAJTJA

LOGO.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
1. HYRJE	5
1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR	5
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË	7
2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË (1-2 FAQE)	8
2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE	8
2.2 ÇESHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË / KËSHILLIT TË QARKUT	10
3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË / KËSHILLIT TË QARKUT (1-2 FAQE)	12
3.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË	12
3.2 SFIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT / PARAQITJA E PROJEKTEVE KRYESORE – ARSYET DHE PËRFITUESIT	13
4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË/QARKUT [EMRI] 2027-2029	13
4.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË/QARKUT VAU DËJËS NË VITET 2027-2029	14
4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë/Qarkut Vau Dëjës për vitet 2027-2029	14
2.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë/Qarkut [EMRI] për periudhën 2027-2029	17
4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR	18
5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE	18
5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	18
5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	18
5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit	20
5.1.4 Informacione Bazë mbi Programin	20
6. BUXHETI VJETOR	21
6.1. DOKUMENTACIONI BAZË	21
6.2. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES	21

Lista e Tabelave

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë/Qarkun [EMRI I BASHKISË/QARKUT]	14
Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit	14
Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike	17
Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike	17
Tabela 5. Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funksional (Niveli I, II, III i COFOG)	17
Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	18
Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	18
Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	19
Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit	20
Tabela 9. Informacione bazë mbi Programin	20

Lista e Shkurtimeve

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MF	– Ministria e Financave
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto
SMBV	– Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjecare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve.

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar

kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësitë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësitë vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART¹. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë² (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare³, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon

¹ Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

² 'Afatgjatë' i referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

³ Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së. Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart⁴ i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MF-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

⁴ Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2027-2029 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanëve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) dhe Manualin e Përdorimit të tij.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MF, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Faza 3 e procesit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor përshkon periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor kur NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin e MF). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së.

2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë (1-2 faqe)

2.1 Situata e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore

Bashkia Vau i Dejës kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë e Shkodrës, në lindje me bashkinë Fushë Arrëz ndërsa në jug me bashkitë Vau Dejë dhe Lezhë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Vaut të Dejës. Bashkia e Vaut të Dejës zgjerohet me 5 komuna, të cilat merren

kryesisht me bujqësi, ndërsa zona ka resurse të konsiderueshme ujore. Në të ndodhet hidrocentrali i Vaut të Dejës si dhe HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2, të ndërtuara me koncesion privat gjatë viteve të fundit. Komuna e Bushatit, e cila i shtohet Bashkisë së re është një zonë e njohur për prodhimet bujqësore dhe ka një aktivitet jo të vogël në eksportin e zarzavateve. Nga ana tjetër, Komunitat Shllak dhe Temal gjenden në anën tjetër të liqenit të Vaut të Dejës dhe pa lidhje historike me bashkinë e re. Këto dy komuna janë veçanërisht të varfra me tokë për shkak se një pjesë e konsiderueshme e tyre është përmbytur nga liqeni i Vaut të Dejës. Territori i Vau-Dejës është një territor i dedikuar për përdorimin bujqësor të tokës, mbrojtjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve ujore, ruajtjen e peizazheve malore. Vau-Dejës ruan tokën e saj, të pasur dhe pjellore, prodhuese e ushqimit dhe produkteve natyrore, dhe rrit rolin e saj si një portë hyrëse për në zonat malore të vendit. Në veçanti, ruan dhe kujdeset për peizazhet e saj malore, ku kultura e lashtë, prodhimi i qendrueshëm, dhe njerëzit që i mbajnë gjallë këto vlera janë një ndihmesë në ruajtjen e ekuilibrit të ndjeshëm natyror dhe artificial prodhuar nga tradita shekullore dhe përdorimi i përgjegjshëm i këtyre burimeve, duke krijuar pengesë dhe mbrojtje kundër rreziqeve të luginës, për një jetesë të mirë të një komuniteti të bashkuar dhe të përgjegjshëm. Qyteti Vau-Dejës ka qenë një qytet i vogël dhe shumë i lashtë me emrin Danja që i përket vitit 1127. Ekzistojnë troje të vjetra të kështjellës dhe kishës së Shën Markut ndër më të vjetrat në Ballkan, që sot kanë vlera arkeologjike për studime historike. Vau i Dejës ka të bëjë me qytetin tashmë të zhdukur të Dejës. Deja (ose Danja) ka qenë qytet mesjetar shqiptar shumë i rëndësishëm me një histori vërtet interesante. Qyteti u ndërtua në shek.XI-XII në pikën ku del Drini nga malësitë. Zotëronte rrugën e karvanëve dhe vilte të ardhura të shumta nga doganat që paguheshin për kalimin e Vaut të Dejës. Nga fillimi i shekullit XIII qëndroi nën sundimin e feudalëve serbë. Këtu u fuqizua familja feudale e Zahariajve. Me formimin e principatës së Balshajve, Deja u bë pjesë e saj. Më 1396, Gjergji II Balsha ia kaloi qytetin Venedikut. Në vitet 1423-1443, Deja kaloi dy herë në dorë të osmanëve për tu çliruar në 1443 pas kryengritjes së përgjithshme antiosmane. Zotërimi i Dejës u bë shkak konflikti midis feudalëve N.Dukagjini dhe L.Zaharia në 1445. Pas vrasjes së këtij të fundit, qyteti iu ridorëzua nga e ëma e tij, Venedikut. Ishte pikërisht kërkesa e Skënderbeut që Venediku t'i dorëzonte Dejën që shkaktoi luftën mes tij dhe Venedikut. Skënderbeu e rrethoi në 1447-1448, por nuk e mori dot. Qyteti qëndroi nën Venedikun deri në 1479, kur e ripushtuan osmanët. Pas kësaj, ai nuk u rimëkëmb më. Sot mund të shihet ende Kalaja e Dejës, brenda së cilës janë gërmadhat e një kishë. Në pjesën e poshtme të lugut të Shën Markut (ish vendodhja e stabilizimit të kinezëve) cdo vit ditën e Shën Markut me 25 prill bëhej një panair i madh ku merrnin pjesë e gjithë Zadrima dhe tregetarët e qytetit të Shkodrës të cilët tregtonin të gjitha llojet e mallrave qoftë bujqësore, blegtorale, si dhe vegla pune primitive të asaj kohe të cilat në të gjitha ditët e vitit nuk gjendeshin pas meshe, njerezit blinin tek ky panair. Kjo vazhonte deri në orët e vona të datës 25 prill. Në cep të panairit ishte një ndërtesë e bërë nga inxhinieri Italian "Muci" i cili ishte përgjegjës i ndërtimit të rrugëve Lac-Vau Dejës. Ai ndërtoi këtë shtëpi dykatëshe për familjen e tij gjatë kohës së banimit të tij në Shqipëri e që më vonë shërbeu për popullin e Dejës si ambulancë, e më vonë spital po në Dejës. Kjo është kalaja më e hershme ilire me prijës Leke Zaharine i cili ishte bashkëpunëtor me Gjergj Kastriotin me principatë deri në kufi me Dukagjinin, Lezhë, Pukë e Mirditë që përkojnë edhe sot qendrës së fortë kundër turqëve dhe Venedikut. Këtu është bërë lufta më e madhe ku është vrarë Lek Zaharia me venedikasit dhe shumë luftëtarë të kësaj zone, ku u derdh shumë gjak. Lek Zaharia u varros në Kishën e Shën Mrisë në Vau-Dejës ku është rindërtuar sot. Gjithashtu ndodhet dhe ishulli i Shurllahut i cili është monument i kategorisë së parë dhe ka vlera historike dhe arkeologjike si dhe është zonë që ka prioritet për zhvillimin e turizmit. Vendbanim i hershëm, vend thesaresh të medhenj, sidomos i shume kishave që numërohen 365-Elter, ku cdo ditë do shihej meshë në Elter. Zadrima e epërme bën pjesë në ultësirën perëndimore të Shqipërisë dhe ka një pozitë mjaft të favorshme për zhvillimin ekonomik të saj. Përshkohet nga 2 lumenj, Drini dhe Gjadri

të cilët në periudhën e dimrit sillnin dëmtime mjaft të mëdha. Nëpërmjet grykave të këtyre lumenjve, fryn murlani një erë e fuqishme dhe e thatë e cila shkakton dëme të mëdha në bujqësi. Afërsia që ka me detin Adriatik bën që puhitë e detit të vijnë deri në këto vise. Në Zadrimën e Epërme bën pjesë Hajmeli, Pistulli, Shelqeti, Kaca, Naraci, Mjeda e qyteti Vau-Dejës. Për resurset që ka dhe pjellorinë e tokës u vu re edhe nga pushtuesit e huaj. Si krahinë e rëndësishme e Shqipërise veriore del e pranishme në shumë relacione dhe dokumenta të hershme. Nisin që në shekullin XII-XIII, kur Ana Komena përmend ndër të tjera, fushen e Zadrimës e veprimet luftarake të Romës së Bizantit. Ajo shënon <>. Në një dokument të vitit 1402 shkruhet se kjo krahinë veriore është e pasur me drithëra duke konkuruar dhe Venedikun prandaj Venedikasit vendosen monopole. Kalaja e Sardes dhe e Danjës janë dy kala antike që i japin emër zonës tonë në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare, kala të cilat u shkatërruan nga turqit. Vau Dejës-I ishte një zonë strategjike për vetë faktin se kalonin rrugët antike për tu lidhur me Lindjen dhe Perëndimin. Nga Lisusi vinte rruga e vjetër romane nëpër Nenshat, Hajmel duke kaluar pastaj në Laç e në Qafë të Gurit dhe nëpërmjet grykës së Gomsiqes kalonte në Vau Dejës (Via Pucaea). Vau Dejës është një qendër që daton në kohërat e hershme ilire dhe vërtetësia gjendet tek gjetja e shumë varrezave ilire. Nga Shkodra nëpërmjet lundrave primitive kalonin në stacionin doganor të Vau Dejës në <> për në Orosh e Naim. Në udhëtimin që bën Prashniker (Arkeologu Austriak) thotë: Rruga e parë që duhej të merrej për të shkuar në Vau Dejës (1916) ishte e veshtirë, duke kaluar me lundër primitive dhe u gjendëm përballë një fshati të djegur nga Serbët (Mjeda). Vazhduam rrugën nga Laçi dhe pamë se në mes të Laçit e Naraçit kishte <> të cilët ishin 2 metra të larta me një perimetër 15-20 m. Pra siç shihet zona e Vau-Dejësit njihej që në antikitet me një zhvillim ekonomik mjaft të madh.

Sipas Censurit të vitit 2011 ka një popullsi prej 30,438 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki numëron 48,966 banorë. Bashkia e re ka në një sipërfaqe prej 499.09 km² me një densitet prej 98.11 banorë/km².

Para viteve 90, shumica e banorëve në Vau e Dejës punonin në hidrocentral, në fabrikën e bakrit si dhe në kooperativa bujqësore. Ndërkohë që zhvillimi ekonomik aktual mbështetet kryesisht në bizneset e vogla të shërbimit, të cilat janë të pozicionuara kryesisht në qytetin Vau e Dejës. Niveli i papunësisë është i lartë, ndaj edhe një pjesë e madhe e popullsisë gjendet në emigrim, kryesisht në shtetet e Italisë dhe Greqisë. E veçantë për këtë bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, ku dominon liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës, lumi Drin që vazhdon në shtratin e tij të vjetër që nga pengesa e digës së Hidrocentralit si dhe lumi Gjadër që shpëputet nga lumi i parë, rreth 1 km në juglindje të qytetit të Vaut të Dejës. Sipas Regjistrat Civil të vitit 2023, kjo bashki numëron 52,515 banorë. Bashkia e re ka në një sipërfaqe prej 499.09 km² me një densitet prej 105 banorë/km².

2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikën e Bashkisë / Këshillit të Qarkut

Projektet strategjike prioritare për bashkinë Vau-Dejës konsiderohet ndërhyrjet e mëposhtme, të cilat shfaqin koherencë me objektivat strategjike të përcaktuar në planin e përgjithshëm vendor:

Qendrat urbane

- Zhvillimi i qendrës urbane Vau-Dejës
- Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës

- Zhvillim i qendrës urbane Bushat, Bujqësia, blegtoria
- Realizimi i qendrave agro-ushqimore në Bushat për grumbullimin, magazinimin dhe shpërndarjen e prodhimit
- Politika për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë)
- Sistemimin e asfaltimin e çdo rruge dhe qendrave të fshatrave
- Asistencë Part-Time e vaçantë teknike me specialistë të përfilozuar për dy asete me rëndësi të bashkisë (shkolla profesionale:
 - Kultivimi i perimeve në sera
 - Kultivimi i vreshtave dhe teknologjia e përpunimit të rrushit
 - Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shegë në zona kodrinore, në 6-të fshatra me nga 25 ha në bllok

Turizmi

- Realizimi i ligjës së transportit ujor Vau-Dejës – Koman Përmirësim i rrugës Vau-Dejës – Koman
- Realizimi i itinerarit për turizmin kulturor Vig – Sapë – Danjë – Sardë – Koman.

2.3 Informacion financiar kryesor

Hartimi i projektit buxhetor afatmesëm 2027-2029 është bere bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin 68/2017 date 27.4.2017 “ Per financat e veteqeverisjes vendore” i ndryshuar, udhezimit të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë nr. 23 date 30.07.2018 “Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NJQV”, Udhëzimit nr 7 datë 27.02.2026 të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë “ Pë r pë rgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029 ”, dhe anekset plotësuese

Udhëzimi Plotësues nr 17 datë 10.07.2026 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2027-2029”

Hartimi i Projekt Buxhetit për vitet 2027-2029 është kryer pas një pune gjithëpërfshirëse të administratës së Bashkisë, anëtareve të Këshillit të Bashkisë, Njësise Administrative, komunitetin e biznesit, komunitetin e banoreve, si dhe aktore të ndryshëm të shoqërisë civile. Përgatitja e buxhetit është paraprirë nga dëgjesa dhe komunikim me publikun, Promovimi i transparencës në krijimin e instrumenteve financiarë ndaj komunitetit përbën një detyrim ligjor për organet shtetërore, por në fakt është edhe një detyrim moral që kanë institucionet e qeverisjes vendore ndaj komunitetit që përfaqësojnë. Hartimi i Buxhetit u përfshi në një cikël të plotë buxhetimi sipas kërkesave ligjore, duke i ndjekur të gjitha hapat të përcaktuara në ligj. Administrata e Bashkisë është bazuar kryesisht ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe ligjin nr.146/2014 “Për konsultimin publik”, përveç akteve ligjore dhe nënligjore teknike dhe specifike të sipërcituara të domosdoshëm për hartimin e këtij instrumenti financiar. Ky projekt buxhet është një instrument i rëndësishëm financiar që përveçse të promovojë transparencën, duhet të ketë një impakt të gjerë në Bashkinë Vau Dejës, duke përfaqësuar qoftë zonat urbane, qoftë zonat rurale që janë bashkuar në kuadër të reformës territoriale, si dhe të rikthejë mbarsht në shërbime të investimeve të ardhurat e mbledhura nga komuniteti në formën e taksave dhe tarifave vendore. Planet e shpenzimeve për çdo program janë hartuar brenda burimeve që Bashkia ka në dispozicion (sipas kalendarit të miratuar më parë mbi përgatitjen e PBA dhe

udhwzimit të kryetarit të bashkisë). Ky dokument përdoret për të informuar Këshillin Vendor dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të Bashkisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisjes Vendore. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të Buxhetit Vjetor.

3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë / Këshillit të Qarkut

3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

Vizioni i zhvillimit të Vau-Dejës përbëhet nga objektivat strategjike vijuese:

- Pajisja me shërbimet bazë Lëvizja me mënyra të ndryshme
- Qendrat urbane
- Turizmi
- Bujqësia, blegtoria dhe kultivimi i peshkut
- Energjia

Objektivi i parë strategjik përfshin ato veprime të nevojshme për të pajisur territorin me kushtet minimale të strukturimit dhe funksionimit për të sjellë komunitetin lokal në gjendje për të ndërmarrë rrugën e zhvillimit. Bëhet fjalë për veprime që kryhen për të garantuar infrastrukturën bazë, shërbimet sociale thelbësore, sigurinë dhe gjallërinë. Ai artikullohet në programet e mëposhtme:

- Përmirësimi i rrjeteve teknike
- Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit
- Shërbimet ndaj qytetarëve

Objektivi i dytë strategjik përmban veprime të nevojshme në përmirësimin e lëvizjes, dhe nëpërmjet formave të përshtatshme të integritetit të modaliteteve të ndryshme. Kjo artikullohet në programet e mëposhtme:

- Rrugët automobilistike
- Korridori lumor
- Ndërrhyrje të tjera për lëvizjen

Objektivi i tretë strategjik synon të ndjekë objektivin për të realizuar në territor pole urbane, të afta për të ofruar funksionet komplekse të sistemit urban. Duke qenë përballë një situatë në të cilën zhvillimi i vendbanimeve ka ndjekur trende spontane dhe jo të udhëhequra, ky objektivi kërkon të krijojë një hierarki funksionale të qendrave të banuara, i konsideruar si kusht thelbësor që struktura urbane të kryejë një funksion aktiv në mbështetje të zhvillimit të komunitetit lokal. Programet që e përbëjnë atë janë:

- Pole shërbimi për territorin përreth
- Zhvillimi i qendrave lokale
- Rikualifikimi urban

Objektivi i katërt strategjik paraqet elemente të zhvillimit socio – ekonomik bazuar në mundësinë e përdorimit për qëllime turistike të burimeve të rinovueshme në territor. Bëhet fjalë për veprime që ndërmerren për t'i dhënë vlera potencialeve natyrore dhe kulturore që ekzistojnë në territor. Programet në mbështetje të këtij objektivi janë:

- Turizmi mjedisor
- Turizmi kulturor
- Ndërrhyrjet e tjera për zhvillimin e turizmit

Objektivi i pestë strategjik ka tendencë të zhvillojë potencialin e lidhur me prodhimin primar të lidhur pikërisht me aktivitetin bujqësor, blegtoral dhe me kultivimin e peshkut. Programet e identifikuar janë:

- Strukturat e shërbimit
- Rritje e prodhimit

Objektivi i fundit strategjik kërkono të përqendrohet në zhvillimin e një resursi tjetër që është i pranishëm në mënyrë tradicionale në territor, atë të prodhimit të energjisë elektrike. Bëhet fjalë për veprime të ndërmarra për të zhvilluar prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, edhe nëpërmjet diferencimit të cikleve të saj prodhuese. Programet e identifikuar janë:

- Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme
- Diferencimi i prodhimit të energjisë

Bashkimi sinergjik dhe plotësues i gjashtë objektivave strategjike të identifikuar, konsiderohet i përshtatshëm në përcaktimin e një vizioni të aftë për t'i dhënë komunitetit lokal një rrugë rritjeje dhe zhvillimi, duke u bazuar në efektin shumëfishues të veprimeve të veçanta.

3.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit / Paraqitja e Projekteve Kryesore – Arsytet dhe Përfituesit

- Menaxhimi i burimeve natyrore Shërbimet bujqësore dhe blegtorale
- Përmirësimi i aksesit në zonat rurale me qëllim zbutjen e pabarazive dhe ofrimin e shërbimeve administrative në të gjithë territorin e Bashkisë
- Menaxhimi i burimeve ujore Inkurajimi i efektivitetit dhe efikasitetit në kryerjen e shpenzimeve publike
- Lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve strategjiko-politike të Qeverisjes Vendore me shpërndarjen e burimeve dhe kryerjen e shpenzimeve publike
- Zhvillimi ekonomik me theks në mjedis mjedisit në mënyrë që të garantohet mbrojtja e ekosistemeve dhe vlerave të shumta natyrore.
- Boshtet kryesore të zhvillimit ekonomik do të jenë zhvillimi rural (bujqësia dhe blegtoria), turizmi, industria e lehtë/përpunimi, shërbimet, dhe ekonomia e të ardhmes e bazuar në sistemet e teknologjisë së informacionit
- Integrimi i brezave të rinj në ekonomi, dhe krijimin e mundësive për iniciativat në kuadër të rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË/ VAU DEJËS 2027-2029

2027-2029

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Vau Dejës gjatë periudhës 2027-2029, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike, nëse janë planifikuar të tillë. [Pjesa e dytë e fjalisë pararendëse të fshihet nëse nuk janë planifikuar projekte të mëdha investimi]. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2027-2029, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të

shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2027-2029. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Bashkia. [Fjalja e fundit që duhet të fshihet nëse nuk janë planifikuar projekte të mëdha investimi].

Tabela 1 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj.

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë Vau Dejës

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vjetor (SMBV), këtu duhet kopjuar RAPORTI PBA9: INFORMACION MBI NJVQV/PROGRAMIN e këtij sistemi. Në këtë rast ky raport duhet gjeneruar në nivel të NJVQV]

4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Vau Dejës në vitet 2027-2029

4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Vau Dejës për vitet 2027-2029

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA2: PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE i këtij sistemi.]

4.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Vau Dejës

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

A. Taksat dhe Tarifat Vendore

A.1 Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

Parashikimi për vitet 2027-2029 ka një rritje të lehtë, nga viti në vit, ku bazohet te zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- *Percaktimit të saktë të kryefamiljareve sipas rregjistrimit të gjendjes civile.*
- *Mbështetja nga agjentë tatimorë,*
- *Rritja pak a shumë e nr. bizneseve aktive, duke formalizuar aktivitetet e tyre.*
- *Rritja e nr. të sipërfaqeve të ndertesave nga ndertimet e reja, si dhe evidentimi i matjeve të sipërfaqeve të objekteve të bizneseve.*
- *Rritja e nr. të formalizimit të pronave, nëpërmjet certifikatave të pronësive dhe lejeve të legalizimit.*
- *Shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, bashkëpunimit të pritshëm me institucione si ZRRPP, ALUIZNI,*
 - *Krijimi dhe implementimi i programit të taksave vendore, i cili ka ndikuar në përmirësimin e cilësive saktesive se të dhenave si dhe në zgjerimin e bazës së taksapaguesve, dhe shpejtesisë për kryejën e shërbimit, gjithashtu ndikon në uljen e evazionit fiskal.*

A.2 Tarifat Vendore

Tarifat vendore përfshijnë tarifën për:

a) tarifa për zënie dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave; b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve; c) tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet; ç) tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit; d) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënie e licencave, lejeve e autorizimeve; dh) tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethanat të përcaktuara në ligj; e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore; ë) tarifa të tjera, të përcaktuara në ligj.

Parashikimet në rritje të tarifave për periudhën 2027-2029, ka ardhur si rezultat i faktoreve të mëposhtme:

- *Rritja e tarifës së pastrimit dhe ndricimit duke filluar në vitin 2024, nga rritja e kostos së ketyre shërbimeve.*
- *Ndryshimet e sipërfaqeve të ndertesave të objekteve të bizneseve, ku biznesi i vogël tarifën e pastrimit e ka në varesi të sipërfaqes së ndertesës, e cila ka pësuar rritje*
- *Formalizimi i shumë bizneseve dhe dhenia e licencave, autorizimeve të automjeteve.*
- *Rritja e shpenzimeve nga Bashkia për shërbimin e ujitjes kullimit, duke pastruar të gjithë kanalet kulluese dhe vaditeve.*
- *etj*

B. Të ardhurat nga Menaxhimi i Pasurive Publike

Të ardhurat nga menaxhimi i pasurive publike përfshijnë të ardhurat e gjeneruara nga dhënia me qira e tokës bujqësore, pronës, tokës dhe pajisjeve palëve të treta.

Të ardhurat e parashikua me rritje kanë ardhur si rezultat i rritjes së dhenies me qira të pronave publike të Bashkisë e sidomos në pyje dhe kullota, ku është rritur numri i kërkesave për marrje me qira, kështu ka ndikuar edhe hapësirat reklamuese për zhvillimin e turizmit në territorin e Bashkisë Vau dejes.

C. Të Ardhura të Tjera të Veta

Të ardhurat e tjera përfshijnë ato të gjeneruara nga: pozicionet aksionare të bashkisë; ndëshkimet dhe gjobat; grante nga marrëveshjet ndërkombëtare apo nga qeveritë e huaja; etj.

Ndryshimet kanë ardhur si rezultat i fakteve të viteve të kaluara ku ka pasur grante të brendshme dhe nga OJF, gjithashtu edhe në të ardhmen pritet të ketë marrëveshje dhe bashkepunime me shoqata të ndryshme.

4.1.1.2 Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Bashkia merr një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore nga tatimi mbi të ardhurat personale, taksa e regjistrimit të automjeteve dhe renta minerale. Informacioni për këto të ardhura është paraqitur në këtë nën-seksion.

A. Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Të ardhurat e ndara nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale si të nëpunësve publikë, ashtu edhe të atyre të punësuar në sektorin jo-publik si dhe tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga individë nga interesi, qiraja, llotaritë, lojërat dhe burime të tjera.

Të ardhurat nga Tatimi mbi të ardhurat personale kanë qenë në rritje vitet e kaluara, dhe orientimet janë të kënaqësive edhe për vitet e ardhshme, prandaj edhe parashikimi ka trend rritës.

B. Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura

Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura është pjesë e taksave të ndara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përftojnë 25% të të ardhurave totale të gjeneruara nga kjo taksë. Taksa e mjeteve të përdorura është një taksë që na ndikon në të ardhurat totale, e cila ka pësuar rritje nga viti në vit, prandaj edhe kjo taksë është parashikuar me rritje.

C. Renta Minerare

Çdo person fizik ose juridik, i cili është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për këtë fushë, duhet të paguajë qira për burimet natyrore të nxjerra nga, mbi/nën tokën e Republikës së Shqipërisë. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ku kryhet aktiviteti marrin 5 përqind të të ardhurave nga renta minerare.

Te ardhura nga renta minerare eshte nje e ardhur e paperfillshme, ku edhe parashikimi eshte sa per forme, sepse nuk pritet ndonje e ardhur ndikuese.

- C. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme (97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë).

Kjo e ardhur nuk ka pesuar rritje, pasi eshte me luhatje nje vit mund te kemi , ndersa vitin tjetër jo, kjo varet nga procedurat dhe kerkesat e subjekte per nje veprim te tille nga ASHK

- D. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme (97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë).

4.1.1.3 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

4.1.1.4 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar sektoriale për periudhën afatmesme komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

2.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë/Qarkut [EMRI] për periudhën 2027-2029

Tabela 3, paraqet shpenzimet faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve gjatë periudhës 2024 deri në 2029.

Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA3: SHPENZIMET E NJVQV DHE PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK i këtij sistemi. Në këtë rast, ky raport duhet gjeneruar në nivel NJVQV]

Tabela 4, paraqet shpenzimet totale faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilin program buxhetor për periudhën 2024-2029.

Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA5: SHPENZIMET SIPAS PROGRAMIT DHE KLASIFIKIMIT EKONOMIK i këtij sistemi.]

Tabela 5. Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funkcional (Niveli I, II, III i COFOG)

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA4: SHPENZIMET E NJVQV SIPAS KLASIFIKIMIT FUNKSIONAL (NIVELI I, II, III i COFOG) i këtij sistemi.]

4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR

Përmbledhje e çështjeve kryesore të investimeve publike (prioritare);

[Në këtë seksion kërkohet të paraqitet një analizë e shkurtër e projekteve kryesore (madhore) të investimeve publike, nëse ka të tillë. Lista e gjithë projekteve do të paraqitet në vijim në një tabelë të veçantë sipas programeve]

[Nëse nuk ka investime madhore në proces, ky seksion të fshihet fare]

5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE

Buxheti total i Bashkisë Vau Dejës menaxhohet sipas 22 programeve të shpenzimeve. Ky seksion i dokumentit të PBA-së paraqet planet e shpenzimeve që lidhen me performancën për secilin vit të PBA-së, për secilin nga programet e shpenzimeve të Bashkisë. Çdo nën-seksion (3.1 deri në 3.X) paraqet informacionin e performancës të planifikuar dhe kostot përkatëse për një program. Për secilin program informacioni i paraqitur konsiston në:

- Shpenzimet totale të programit sipas kategorisë ekonomike (paga dhe sigurime, shpenzime korente dhe shpenzime kapitale) për dy vitet e kaluara (fakti), vitin aktual (buxheti fillestar dhe i pritshmi) dhe tre vitet e ardhshme (parashikimi);
- Politika e Programit (qëllimet e politikës së programit, objektivat e programit dhe treguesit përkatës të performancës);
- Planet e shpenzimeve të Produkteve të Programit;
- Projektet e investimeve; dhe
- Të dhëna dhe statistika të përgjithshme të programit.

Tabela 5, paraqet informacion mbi shpenzimet totale të programit sipas kategorive ekonomike për dy vitet e mëparshme (faktin), vitin aktual buxhetor (buxheti fillestar dhe i pritshmi) dhe tre vitet e ardhshme të PBA-së (parashikimi).

Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA3: SHPENZIMET E NJVQV DHE PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK i këtij sistemi. Në këtë rast, ky raport duhet gjeneruar në nivel programi]

5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Ky nënseksion ofron informacion mbi planet e performancës së programit. Deklarata e Politikës së Programit është paraqitur në Tabelën 6, duke artikuluar qëllimet e politikës së programit, objektivat e politikës së programit dhe treguesit përkatës të performancës për çdo vit të PBA-së.

Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA6: DEKLARATA SË POLITIKËS SË PROGRAMIT i këtij sistemi.]

5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Ky nënseksion, ofron informacion mbi planet e ofrimit të shërbimeve të programeve dhe kostot përkatëse. Për secilin Objektiv të Politikës së Programit, paraqitet informacion për produktet që do të kontribuojnë në arritjen e këtyre objektivave. Informacioni për produktet përfshin emrin e produktit, përshkrimin e produktit, sasinë e planifikuar, shpenzimet totale dhe shpenzimet për njësi të produktit.

Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA7: SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT i këtij sistemi.]

5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit

Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA8: PROJEKTET E INVESTIMEVE i këtij sistemi.]

5.1.4 Informacione Bazë mbi Programin

Ky seksion i dokumentit paraqet të dhëna dhe statistika specifike të programit, që mund ta ndihmojnë lexuesin të kuptojë më mirë profilin dhe kontekstin e programit.

Tabela 9. Informacione bazë mbi Programit

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA9: INFORMACION MBI NJVQV/PROGRAMIN i këtij sistemi. Në këtë rast ky raport duhet gjeneruar në nivel programi]

6. BUXHETI VJETOR

Dokumentacioni i Buxhetit Vjetor konsiston në raportet e mëposhtme të gjeneruara nga Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor.

6.1. Dokumentacioni Bazë

- Raporti BV1: Buxheti i NJVQV sipas Programeve dhe Njësive Shpenzuese
- Raporti BV2: Tavanet e PBA sipas Programeve
- Raporti BV3: Parashikimi i të Ardhurave
- Raporti BV4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Ekonomik
- Raporti BV5: Numri i Punonjësve të NJVQV

6.2. Dokumentacioni Shoqërues

- Raporti BV6: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimeve Buxhetore
- Raporti BV7: Lista e Projekteve të Investimeve të NJVQV
- Raporti BV8: Efekti Financiar I Përrjashtimeve apo Lehtësimeve Fiskale
- Raporti BV9: Lista e Njësive Shpenzuese të NJVQV
- Raporti BV10: Deklarata e Politikës së Programit
- Raporti BV11: Detyrimet e Prapambetura
- Raporti BV12: Plani i Menaxhimit të Risqeve
- Raporti BV13: Lista e Projekteve Konkensionare / PPP
- Raporti BV14: Shoqëritë Aksionere Publike
- Raporti BV15: Plani i Arkës

Relacion

Mbi rishikimin e planifikimit të të ardhurave për PBA 2027-2029

2.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Vau-dejes.

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës nga burimet qendrore. Këto burime të ardhurash Bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Llogaritja e të ardhurave mbështetet në:

- 1.Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar;
- 2.Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar;
- 3.Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".
4. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vau dejes, nr 71 date 26.11.2020 "Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vau dejes", të ndryshuar

Planifikimi i të ardhurave nga taksat&tarifat është rishikuar duke u është mbështetur në disa faktor, llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë, të cilat janë të përcaktuara në dokumentin "Pakete Fiskale", e cila përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj. Paketa fiskale e Bashkisë Vau dejes për këtë kategori e hartuar dhe e ndryshuar edhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh dhe të vogël, banorëve të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit, këshilltarë etj., pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj. sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

Politikat incentivuese në taksa:

- *Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime banimi deri në 30% nga referenca ligjore, për zonat malore.*

- *Taksë banese zero për pensionistët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.*

- *Nivelin minimal ligjor për taksën e ndikimit në infrastrukture*

Politikat incentivuese në tarifa:

- *Tarifa të reduktuara deri në 50% për invalidet, verberit*

- *Kryefamiljaret femra që trajtohen me ndihmë ekonomike.*

- *Gra krefamiljare viktime të dhunes në familje apo objekt trafikimi.*

- *Tarifa 0 (zero) për fermerët që janë regjistruar me NIPT nga Drejtoria Tatimore*

- *Tarifa 0(zero)subjektet që perfitojne projekte nga Zyra e Punes(START-UP)ne vitin e pare.*

Bashkia Vau dejes, tashmë, ka ndërtuar një sistem të integruar me një ndalesë për regjistrimin dhe shërbimin për taksa paguesit biznes dhe familje të shpërndarë në të gjithë territorin e Bashkisë. Janë ndërtuar bazat e të dhënave gjithnjë e më të sakta të taksapaguesve, sipas kategorive, biznes dhe familje, dhe nga viti në vit punohet për të siguruar të dhëna gjithnjë e më të sakta për bazën e taksueshme dhe nivelin e aplikueshëm të tarifave sipas llojit.

Bashkia Vau dejes, ka kërkuar lidhjen e të dhënave për pasuritë e paluajtshme që disponon ASHK (Agjensia Shtetërore e Kadastrës) me sistemin e Kadastrës Fiskale që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.


Sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit e tyre brenda kufijve e sipas kritereve të përcaktuara me ligj.

Planifikimi për vitet 2027-2029, është rishikuar duke u parashikuar me rritje të planit të të ardhurave, ku kanë ndikuar realizimi i këtij 6-mujore, tek disa taksa, si Tatimi mbi të ardhurat, Taksa e ndikimit në infrastrukture, taksa e mjeteve të përdorura, dhe të ardhura të tjera

Të ardhurat e veta të Bashkisë të kategorizuar sipas llojit të të ardhurave, për periudhën 2027-2029, parashikohen në vlerat si më poshte

ne (000/leke)

Vitet	2027	2028	2029
Ardhurat e veta totale	192,610	193,646	194,077
Ardhura nga taksat vendore	57,592	58,765	58,765
Ardhura nga taksat e ndara	35,284	36,072	36,938
Ardhura nga tarifat vendore	48,268	48,385	48,381
Ardhura të tjera	51,465	50,424	49,993



Të Ardhurat e Bashkisë (në mijë ALL dhe në % ndaj totalit) per 3 vitet e para buxhetore dhe 3 vitet e ardhshme buxhetore paraqiten si ne grafikun e meposhtem:



Të ardhurat e veta, që mbliidhen nga administrata e Bashkisë në vitet 2027-2029 parashikohen që të kenë një trend rritje afersisht 1% për tre vitet e ardhshme.

Kategoritë e taksave dhe tarifave qe ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave nga burimet e veta për vitet 2027-2029 janë kryesisht taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 21 %, taksa e mjeteve te perdorura që zë rreth 11 %, tarifa për pastrimin zë rreth 18 %, tarifa e ndriçimit publik që zë rreth 4 %, tarifa të tjera ku përfshihen tarifat administrative zëzë rreth 1 %.

Planifikimi i të ardhurave të veta për vitet 2027-2029 i kategorizuar sipas llojit të të ardhurave paraqitet si më poshtë:

Ne
mije
leke

LLOJET E TË ARDHURAVE	Fakti	Fakti	Fakti	Parashikimi			
	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029
TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA GJITHSEJ	100,927	156,199	160,949	177,000	192,610	193,646	194,077
TË ARDHURA TATIMORE/NGA TAKSAT VENDORE	62,230	67,665	68,590	78,554	92,876	94,837	95,703
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	98	176	150	-	-	-	-
2% tatimi mbi të ardhurat personale	12,790	14,308	11,944	10,100	13,243	13,530	13,900
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	22,011	26,623	26,151	40,421	40,604	40,670	40,670
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	11,291	12,643	13,223	15,184	15,336	15,391	15,391
<i>Ndërtesa banimi</i>	3,732	4,926	4,223	5,350	5,403	5,450	5,450
<i>Ndërtesa të tjera</i>	7,559	7,718	9,000	9,834	9,933	9,940	9,940
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	5,700	8,385	7,251	19,234	19,234	19,234	19,234
Taksa mbi truallin	5,019	5,595	5,677	6,003	6,034	6,046	6,046
<i>Të ardhura nga taksa mbi truallin familje</i>	131	129	182	222	223	224	224
<i>Të ardhura nga taksa mbi truallin biznes</i>	4,888	5,465	5,495	5,781	5,810	5,821	5,821
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	-	870	391	442	456	482	482
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	7,267	3,481	5,210	5,553	14,532	15,612	15,612
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	-	-	-	10	10	10	10
Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura	19,046	20,223	22,895	20,000	22,000	22,500	23,000
Të ardhura nga taksa e rentës minerare	1	137	3	3	4	4	3
Të ardhura nga taksa e akteve të pullë	18	25	22	25	27	28	25
Të ardhura nga taksa e tabelës&reklame	1,001	1,823	1,824	2,000	2,000	2,000	2,000
Të ARDHURAT JOTATIMORE	38,697	88,534	92,360	98,446	99,734	98,809	98,374
Të ardhurat nga Tarifat vendore	29,401	40,750	41,786	47,703	48,268	48,385	48,381
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	20,676	28,054	27,821	30,910	31,325	31,423	31,423
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga familjet	5,550	8,357	7,612	10,170	10,450	10,542	10,542


Të ardhura nga tarifë pastrimi nga institucione	292	125	605	523	523	523	523
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga biznesi	14,835	19,573	19,604	20,217	20,351	20,358	20,358
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	3,963	6,870	7,216	7,430	7,531	7,602	7,602
Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga familje	1,939	3,400	3,353	3,220	3,313	3,327	3,327
Të ardhura nga tarifë ndricimi nga institucione institucione	28	25	20	40	40	40	40
Të ardhura nga tarifë ndricimi nga biznesi	1,995	3,444	3,843	4,169	4,178	4,236	4,236
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	2,759	3,064	3,224	3,728	3,742	3,808	3,808
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga familjet	739	981	833	1,181	1,183	1,236	1,236
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga institucionet	28	18	10	28	28	28	28
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga biznesi	1,992	2,065	2,382	2,519	2,530	2,543	2,543
Tarife e mirembajtjes se infrastruktures se ujitje-kullim	1,114	1,598	1,449	3,397	3,397	3,397	3,397
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	889	1,164	2,076	2,238	2,274	2,155	2,151
Nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	156	125	193	160	164	170	195
Nga Tarifat e licënsimit të veprimtarive të transportit	121	299	120	120	122	128	125
Nga tarifa parkimi për mjetet e licënsuara, dhe për vendparkime publike	367	492	419	489	493	501	450
Nga tarifë për dhënie licënsa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	-	-	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	5	1	-	173	173	93	-
Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ	240	222	316	285	310	250	350
Nga tarifa për zënien e hapësirave publike	-	25	29	10	11	12	30
Nga linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	-	-	-	1	1	1	1
Te tjera administrative				1		1	-
TË ARDHURA TË TJERA	9,296	47,784	50,574	50,743	51,465	50,424	49,993
Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)	1,572	1,802	2,209	1,170	895	854	500
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (ndertese)	681	696	642	618	618	618	618
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (truall)	151	169	747	130	130	130	130
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (tokë bujqësore)	743	694	752	768	768	768	768
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (pyje-kullota)	4,009	13,098	33,599	46,048	46,048	46,048	46,969
Të ardhura nga sekuestime dhe zhdëmtime	-	-	-	1	1	1	1
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve	-	-	-	1	1	1	1

Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	-	-	-	1	1	1	1
Të ardhura nga shitja dok. tenderi	33	20	6	2	2	2	5
Te ardhura te tjera jotatimore	371	190	619	5	2	2	2
Të ardhura nga sponsorizimet+Nj.qev.vendore qendrore	1,736	31,116	12,000	2,000	3,000	2,000	1,000

Tabela e meposhteme pasqyron te ardhurat sipas njesive administrative:

Vitet	Total	NJ.A VAUDEJES	NJ.A BUSHAT	NJ.A HAJMEL	NJ.A VIG-MNELE	NJ.A SHLLAK	NJ.A TEMA L
Viti 2027	192,610	74,267	95,253	15,985	1,777	1,776	3,552
Viti 2028	193,646	75,027	95,470	16,026	1,781	1,781	3,561
Viti 2029	194,077	75,458	95,470	16,026	1,781	1,781	3,561

Peshen kryesore ne bazen e taksueshme te te ardhurave te planifikuara, e ze Njesia Administrative Bushat me afro 50% te planit dhe Njesia Administrative Vau-dejes, me rreth 38% ndersa njesite e tjera kane nje peshe specifike te vogel, kjo si rrjedhoje e numrit te madh te popullsisë dhe numrit te biznesve, ne keto dy njesi.



A. Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

Per vitet 2027-2029 parashikohet që të ardhurat nga taksat vendore të përbejnë rreth 27% të totalit të të ardhurave nga burimet e veta të Bashkisë.

A.1. Te Ardhura nga Taksa mbi pasurine e paluajtshme

Këto të ardhura përfshijnë të ardhurat nga :

- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesat e banimit dhe mbi ndërtesat e tjera)
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin (familje, biznes)

Parashikimi për vitet 2027-2029 ka një rritje të lehtë, nga viti në vit, ku bazohet te zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- Percaktimit të saktë të kryefamiljareve sipas rregjistrimit të gjendjes civile.
- Rritja pak a shume e nr. bizneseve aktive, duke formalizuar aktivitetet e tyre.
- Rritja e nr. të sipërfaqeve të ndërtesave nga ndërtimet e reja.
- Rritja e nr. të formalizimit të pronave, nëpërmjet certifikatave të pronësive dhe lejeve të legalizimit.
- Shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarrja, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin.
- Krijimi dhe implementimi i programit të taksave vendore, i cili ka ndikuar në përmirësimin e cilësive saktësisë së të dhënave si dhe në zgjerimin e bazës së taksapaguesve, dhe shpejtesisë për kryejnë e shërbimit, gjithashtu ndikon në uljen e evazionit fiskal.

Taksa mbi pasurine e paluajtshme zë pjesën më të madhe rreth 28% të të ardhurave të planifikuara nga taksat vendore, dhe paraqitet në tabelën e mëposhtë:

Ne 000/leke

Emertimi/Vitet	2027	2028	2029
Taksa mbi pasurine paluajtshme	40,604	40,670	40,670
Taksa e ndërtesës	15,336	15,391	15,391
Taksa e truallit	6,034	6,046	6,046
Taksa mbi tokën bujqësore	19,234	19,234	19,234

A.2. Taksa e fjetjes ne hotel.

Kjo takse eshte parashikuar nje rritje duke parashikuar rritjen e turizimit , dhe numrit te vizitoreve ne vendin tone.

	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
Taksa e fjetjes në hotel	456	482	482

A.3. Taksa e tabelës.

Ne fakt kjo takse per shkak vleres se madhe nga percaktimet ligjore, qe duhet te paguajne subjektet private, kane bere zvogelimin e siperfaqes te tabelave apo reklamave te tyre dhe si rrjedhoje, e ketij indikator, nuk kena parashikuar rritje.

	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
Taksa e tabelës	2,000	2,000	2,000

A.4. Taksa e ndikimit ne infrastrukture.

Taksa e ndikimit ne infrastrukture, eshte parashikuar rritje, per arsye te rritje nga nje vit ne tjetrin duke u bazuar ne rritjen e te ardhurave per kete takse.

	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	14,532	15,612	15,612

A.5 Taksa e mjeteve te perdorura

Taksa e mjeteve te perdorura, eshte parashikuar me rritje, per arsye te rritjes se kesaj te ardhure nga viti ne vit.

	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
Taksa e mjeteve te perdorura	22,000	22,500	23,000

B. Tarifat Vendore

Tarifat vendore përfshijnë tarifat për:

a) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve; b) Tarifa për ndricimin, c) Tarifa për gjelberimin, e) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënie e licencave, lejeve e autorizimeve; e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

B.1. Tarifa për shërbimet publike (pastrim, ndricim, gjelberim, mirembajtje ujë kullim, shërbim administrativ)


Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.

Për vitin 2027-2029 të ardhurat e parashikuara nga tarifat përbëjnë rreth 27 % të të ardhurave të veta.

Pjesën më të madhe në kategorinë e të ardhurave nga tarifat vendore e zënë të ardhurat nga tarifat për ofrimin e shërbimeve publike si pastrimi e largimi i mbeturinave me 65 %, gjelbërimi me 7%, ndriçimi publik me afro 16%, etj.

Vitet	2027	2028	2029
Tarifat vendore	48,268	48,385	48,381
<i>Tarifa e pastrimit</i>	<i>31,325</i>	<i>31,423</i>	<i>31,423</i>
<i>Tarifa e ndricimit</i>	<i>7,531</i>	<i>7,602</i>	<i>7,602</i>
<i>Tarifa e gjelberimit</i>	<i>3,742</i>	<i>3,808</i>	<i>3,808</i>
<i>Tarifa e mirembajtje ujë kullim</i>	<i>3,397</i>	<i>3,397</i>	<i>3,397</i>
<i>Tarifa e shërbimit administrativ</i>	<i>2,274</i>	<i>2,155</i>	<i>2,151</i>

Paraqitet në grafikun e mëposhtem



Parashikimi i të ardhurave nga tarifat për pastrimin, ndriçimin dhe gjelbërimin, etj bazohet tek kapaciteti aktual dhe në rritjen e njësive taksapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

Kontribuesit e taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat e rregjistrave për taksapaguesit, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga këshilli bashkiak.

Në total kapaciteti i taksapaguesve është parashikuar rreth 14.600 (familje, biznese dhe institucione). Peshën numerike më të madhe të taksapaguesve e përbëjnë familjet, rreth 90%.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e kapacitetit të taksapaguesve sipas kategorive dhe njësive administrative.

KAPACITETI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE (Numri)

Nr	Bashkia Vau dejes	Familje	Biznese
1	Njësia Administrative Vau dejes	4226	224
2	Njesia Administrative Bushat	6491	363
3	Njesia Administrative Hajmel	2167	43
4	Njesia Administrative Vig-Mnele	460	3
5	Njesia Administrative Temal	338	14
6	Njesia Administrative Shllak	670	3
	TOTALI	14.352	650

Taksapaguesit familjarë

Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke iu referuar kryefamiljeve rezidente sipas regjistrat gjendjes civile.

Në total numri i familjeve që përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Vau dejes është 14352. Në paketën fiskale të Bashkisë Vau dejes janë parashikuar lehtësi fiskale dhe numri i këtyre familjeve arrin në rreth afro 14.000 familje, duke bereperjashtime si pensionistë, invalid, familje me ndihmë ekonomike, familje njëprindërore, familje me probleme sociale etj.

Taksapaguesit biznese dhe institucione


Bazuar në rregjistrat aktual, në total, numri i bizneseve dhe institucioneve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të Bashkisë Vau dejes është 650. Biznesi i vogël zë rreth 80% të numrit total të bizneseve.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për bizneset dhe institucionet, sipas Njësive Administrative:


KAPACITETI I BIZNESEVE DHE INSTITUCIONEVE TAKSAPAGUESE

Nr.	Bashkia Vau-Dejes	Totali	Biznesi vogel	Biznesi madh	Institucione
1	Nj.A qender Vau-dejes	224	180	42	2
2	Nj.A Bushat	363	283	80	0
3	Nj.A Hajmel	43	38	5	0
4	Nj.A.Vig-Mnele	3	3	0	0
5	Nj.A.Shllak	3	2	1	0
6	Nj.A Temal	14	14	0	0
	TOTAL	650	530	128	2

Shperndarja e biznesit ne Bashkine Vau Dejes




Raporti i biznesve sipas xhiros



Ne tabele vihet re se peshen me te madhe e ze biznesi i vogel, dhe sidomos ai me aktivitet tregti e sherbime

Kapaciteti i bizneseve sipas natyres dhe madhësisë

Nr.	Sektori	Biz.Madh	Biz.Mesem	Bis. Vogel	gjithsejt
1	Sherbimeve	33	2	273	308
2	Prodhim	6	2	56	64
3	Tregti	59	4	154	217
4	Transport	4	0	27	31
5	Ndertimi	8	1	8	17
6	Turizmi	2	0	9	11
7	Institucion	2	0	0	2
	Totali	114	9	527	650



Analiza e risqeve dhe masat për përballimin e tyre

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin. Ligji përmban koncepte dhe përgjegjësi të reja për menaxhimin e riskut në institucionet publike.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Identifikimi dhe menaxhimi i riskut mundëson strukturat drejtuese në çdo njësi në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që kanë për realizimin e aktivitetit në to. Çdo drejtues është i

vetëdëshëm se risku do të ekzistojë dhe nuk do të eliminohet kurrë tërësisht. E rëndësishme është që risku të menaxhohet në mënyrë efektive.

Për realizimin e të ardhurave të veta vendore, njëkohësisht duke ruajtur tendencën për përmirësimin e politikave dhe strategjive incentivuese e zhvilluese të ekonomise lokale, është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut duke kaluar në këto etapa:

a) Identifikimi i objektivave

b) Identifikimi i risqeve të jashtme dhe të brendshme.

c) Analiza dhe vlerësimi i çdo risku (sipas probabilitetit dhe impaktit).

d) Marrja e masave të metejshme, për pakësimin apo reduktimin e riskut.

e) Paraqitja e të gjithë konkluzioneve të arritura

f) Krijimi i hartës së riskut, grupimi në bazë të impaktit dhe probabilitetit të ndodhjes së tyre, duke treguar në këtë mënyrë ato fusha të veprimtarisë së njësisë, ndaj të cilave duhet të tregohet vëmendje e veçantë.

g) Monitorimi dhe raportimi.

h) Hartimi i planit të veprimit.

Regjistri i Riskut

Nr	Përshkrimi i riskut	Risku para kontrollit	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevoja për kontrole të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshlleqet	Zotëruesi i riskut	Ndryshimet në risk që nga detyra e fundit (përkeqësohet => përmirësohet <=> i pandryshuar =)
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1.	Mungesa e informacionit në terren	mesëm-ulët	Monitorime në terren nga inspektorët e zonës	ulët-ulët	po	Përgatitja e planit të punës për evidentim	Spektori i Kontrollit dhe Masave shtrenguese	Përmirësuar
2	Mungesa e informacionit nga Agjencia Shtetore e Kadastrës	mesëm - mesëm	Kërkesa shkresore për informacion	Mesëm - mesëm	Po	Rritja e bashkepunimit me Agjencia Shtetore e Kadastrës	Agjencia e Shtetore e Kadastrës	Pandryshuar
3	Mungesa e informacionit nga QKB-ja	ulët-ulët	Kërkesa shkresore për informacion	ulët-ulët	po	Bashkepunim me QKB-ne	QKR dhe Spektori i Regjistrimit	Përmirësuar
5	Mungesa e informacionit në Njësitë Administrative	mesëm - ulët	Monitorime në terren nga Njësitë Administrative	ulët - ulët	po	Grupe të zgjeruara për evidentimin e taksapaguesve	Njësitë Administrative dhe Spektori Familjar	Përmirësuar
6	Mungesë e informacionit për tokën bujqesore	mesëm - mesëm	Monitorime në terren nga Njësitë Administrative	mesëm - i ulët	po	Bashkepunim me Drejtorinë e bujqësisë	Drejtoria e Bujqësisë dhe Spektori Familjar	Pandryshuar
8	Dokumenacion bazues për taksim	mesëm - mesëm	Pasurimi me dokumentacion i pronësisë	mesëm - ulët	Po	Pasurimi gjatë dhenies së shërbimit ndaj taksapaguesit	Zyra me një ndalesë dhe Spektori Familjar	Përmirësuar

9	Ndjekja e masave shtrënguese	mesëm - mesëm	Njoftime në terren dhe me postë	mesëm - mesëm	po	Përgatija e planveprimit	Spektori i Kontrollit dhe Masave shtrënguese	Permiresuar
10	Rakordim i shpejtë i pagesave	mesëm - mesëm	Marrja ne kohe e arketimeve me banke nga Dega e Thesarit	mesem	jo	Plan veprimi për rakordimin e të ardhurave	Spektori i Taksave dhe tarfiave vendore	Përmirësuar
12	Realizimi i të ardhurave nga bizneset	mesem	Analiza mujore sipas zërave	mesem	po	Shqyrtimi i zërave sipas ecurisë	Spektori i taksave dhe tarfiave vendore	Përmirësuar
13	Realizimi i të ardhurave nga familjet	ulet-ulet	Analiza sipas Njësi Administrative	ulet-ulet	po	Shqyrtimi i sipas ecurisë	Spektori i Taksave dhe tarfiave vendore	Pandryshuar
14	Realizimi i të ardhurave nga agjentë tatimorë	mesëm - ilet	Analiza mujore	mesem	po	Analizë për çdo agjent	Spektori i Taksave dhe tarfiave vendore	Përmirësuar
16	Azhornimi i vazhdueshëm i programit të taksave	ulet-ulet	Bashkëpunim me programuesit për azhornimin e te dhenave në program.	mesem	po	Evidentimi dhe shqyrtimi i nevojave për ndryshime dhe adaptime në program	Spektori i Taksave dhe tarfiave vendore dhe sektori i Kontrollit dhe Masave shtrënguese	Përmirësuar
17	Dhënia e informacionit për taksapaguesit	mesem	Dhënie e shërbimit pranë sportleve	mesem	jo	Kkoha e dhenies pergjigje kerkesave te taksapaguesve	Zyra me Një ndalesë Drejtoria Ekonomike	Përmirësuar
18	Llogaritje e shpejtë e detyrimeve	ulet-ulet	Përfshirje e llogartjes së detyrimit në program taksash	mesem	po	Plotesimi i kerkesave të taksapaguesve	Spektori i Taksave dhe tarfiave vendore	Përmirësuar
19	Evidentim i shpejtë i pagesave	mesëm-	Kontabilizim i shpejtë i të ardhurave	mesem	jo	Monitorimi i kohës për emetimin e evidencave	Spektori i Taksave dhe tarfiave vendore	Përmirësuar
21	Përditësim me standartet e reja ligjore	ulet- ilet	Shyrtimi i njohurive dhe evidentimi i ndryshimeve	ulet- ilet	po	Krahasimi dhe diskutimi periodik mbi njohuritë	Drejtoria Ekonomike	Pandryshuar
22	Njohuri mbi sistemet online të instaluar	ulet- ilet	Shqyrtimi dhe krahasimi mes nevojave dhe programeve	ulet- ilet	po	Perditesime periodike mbi nevojën për zgjerim te njohurive	Drejtoria Ekonomike	Pandryshuar
23	Njohje me eksperiencia të ngjashme dhe trainime profesionale	mesëm- ilet	Trainime dhe diskutime mbi to	ulet- ilet	po	Diskutime dhe konstatime	Drejtoria Ekonomike	Përmirësuar

RELACION

Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 për Bashkinë Vau Dejës

I. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA për Vitet 2027-2029

Percaktimi i tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të PBA për vitet 2027-2029, është realizuar bazuar në nenin 9, 34 dhe 41 të ligjit Nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", të ndryshuar, nenin 37 të ligjit 68/2017 datë 27.4.2017 "*Per financat e vetëqeverisjes vendore*", udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "*Per procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV*",

Udhëzim nr. 7, datë 27.02.2026 "*Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029*" dhe shtojcat plotësuese.

Udhëzim plotësues nr. 17, datë 10.07.2026 "*Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029*" dhe shtojcat plotësuese.

2.3 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transferata e kushtëzuar

Të ardhurat nga transferata e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transferata e kushtëzuar për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së. Udhëzimi nr. 7, datë 27.02.2026 "*Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029*" dhe shtojcat plotësuese.

Transferata e pakushtëzuar, transferata e pakushtëzuar sektoriale dhe transferata e kushtëzuar për vitet 2027-2029 paraqitet në tabelat më poshtë:

❖ Transferata e pakushtëzuar

Transferata e Pakushtëzuar (TP) rregullohet nga Ligji nr. 68, datë 27.04.2017, "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*", i cili përcakton madhësinë dhe mënyrën e ndarjes për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJQV). Si rregull i përgjithshëm, transferata e pakushtëzuar ka për qëllim t'u sigurojë njësitë të vetëqeverisjes vendore diferencën mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur (kapaciteti fiskal). Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transferatës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.

Formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar përcaktohet në nenin 24 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”. Formula identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek popullsia relative, dendësia e popullsisë (që reflekton diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe tek numri faktik i fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç ekualizimit të kostove të shërbimeve që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mbliidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatim fitimi i thjeshtuar i biznesit të vogël, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridikë. Transferta e pakushtëzuar për një bashki ose qark është e barabartë me shumën përkatëse që rezulton nga aplikimi i formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për bashkitë dhe qarqet.

- Transferta e pakushtëzuar për vitin 2027 është në vlerën 341,932 mijë lekë dhe fondi për rritjen e pagave është në vlerën 74,244 mijë lekë, në total Transferta e pakushtëzuar për vitin 2027 është e barabartë me shumën 416,176 mijë lekë, përkatëse që rezulton nga aplikimi i formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për bashkitë.
- Transferta e pakushtëzuar për vitin 2028 është në vlerën 356,784 mijë lekë dhe fondi për rritjen e pagave është në vlerën 74,244 mijë lekë, në total Transferta e pakushtëzuar për vitin 2028 është e barabartë me shumën 431,028 mijë lekë, përkatëse që rezulton nga aplikimi i formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për bashkitë.
- Transferta e pakushtëzuar për një vitin 2029 është në vlerën 371,212 mijë lekë dhe fondi për rritjen e pagave është në vlerën 74,244 mijë lekë, në total Transferta e pakushtëzuar për vitin 2029 është e barabartë me shumën 445,456 mijë lekë, përkatëse që rezulton nga aplikimi i formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për bashkitë.

Keto transferta janë sipas udhëzimit nr 7, date 27.02.2026 “Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2027-2029”, Udhëzim plotësues nr. 17, date 10.07.2026 “Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2027-2029” dhe shtojcat plotësuese.

Tabela 1. Transferta e Pakushtëzuar për periudhën 2027-2029

		në mijë lekë		
Nr	Vitet	2027	2028	2029
1	Transferta e Pakushtëzuar	416,176	431,028	445,456

❖ *Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale*

Pjesa Sektoriale e Transfertës së Pakushtëzuar përfshin financimin për funksionet e reja të transferuara në nivel vendor në vitin 2016 sipas Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Fondet për këto funksione nuk ndahen sipas formulës së ndarjes së transfertës së pakushtëzuar të përcaktuar në nenin 24 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

Funksionet e transferuara janë: personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës.

Sipas udhëzimit nr 7 date 27.02.2026 “Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2027-2029”, Udhëzim plotësues nr. 17, date 10.07.2026 “Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2027-2029” dhe shtojcat plotësuese.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për çdo funksion të transferuar.

Tabela 2. Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale për periudhën 2027-2029

në mijë lekë				
Nr	Vitet	2027	2028	2029
1	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	160,671	160,671	162,278

Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale për periudhën 2026-2028 ka ardhur sipas Udhëzimit nr 7, date 27.02.2026 “Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2027-2029”, Udhëzim plotësues nr. 17, date 10.07.2026 “Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2027-2029” dhe shtojcat plotësuese.

dhe është e detajuar sipas tabelës më poshtë:

Tabela 3. Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale e detajuar për periudhën 2027-2029

në mijë lekë				
Nr	Vitet	2027	2028	2029
1	Konviktet e arsimit parauniversitar	10,118	10,118	10,219
2	Arsimi parashkollor Ndarë me formulë për personelin mësimor	66,163	66,163	66,825
3	Arsimi parashkollor Për stafin mbështetës	1,170	1,170	1,182
4	Arsimi parauniversitar	3,822	3,822	3,860

5	Mbrojtja nga zjarri	21,398	21,398	21,612
6	Mbrojtja sociale	22,296	22,296	22,519
7	Administrimi i pyjeve	9,952	9,952	10,052
8	Rrugët	7,615	7,615	7,691
9	Ujitja dhe Kullimi	15,995	15,995	16,155
10	Menaxhimi i mbetjeve urbane	2,142	2,142	2,163
TOTALI		160,671	160,671	162,278

❖ *Transferta e Kushtëzuar*

Shuma dhe qëllimi i transfertës së kushtëzuar, që Buxheti i Shtetit jep për njësitë e vetëqeverisjes vendore;

Qëllimi i transfertës së kushtëzuar është financimi i shpenzimeve për funksionet e deleguara. Shuma e transfertave të kushtëzuara është rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara, ose të përbashkëta. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës, nga ministritë përkatëse të linjës.

Niveli i transfertës së kushtëzuar është bërë duke u bazuar sipas udhëzimi nr 7 date 27.02.2026 "Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2027-2029", dhe sipas miratimit të tavaneve përgatitore të Bashkisë Vau Dejës". Nga kjo transfertë mbulohen shpenzime për transferimet individuale për pagesë për personat me aftësi të kufizuar, invaliditeti dhe ndihme ekonomike dhe konkretisht niveli i Transfertës së Kushtëzuar është sipas tabelës më poshtë:

Tabela 4: Transferta e Kushtëzuar për periudhën 2027-2029

Nr	Vitet	2027	2028	2029
1	Transferta e Kushtëzuar	413,402	413,402	416,402

Transferta e Totale nga Qeverisja Qendrore

Duke bërë një përmbledhje të tabelave më sipër, total transferta nga qeverisja qendrore për periudhën 2027-2029 janë të detajuara si më poshtë:

Tabela 5: Transfertat Totale nga Qeverisja Qendrore për periudhën 2027-2029

Nr	Vitet	2027	2028	2029
1	Transferta e Pakushtëzuar	416,176	431,028	445,456
2	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	160,671	160,671	162,278

3	Transferta e Kushtëzuar	413,402	413,402	416,402
TOTALI		990,249	1,005,101	1,024,136

Buxheti Total i Bashkisë Vau Dejës për periudhën 2027-2029

Bashkia Vau Dejës dukë përfshirë transfertat e qeverisjes qendore (transferta e pakushtëzuar, transfertat e pakushtëzuar sektoriale, transfertat e kushtëzuar) dhe të ardhurat e planifikuara për periudhën 2027-2029, përbejnë buxhetin total dhe janë të detajuara si më poshtë:

Tabela 6: Buxheti total për periudhën 2027-2029

Nr	Vitet	2027	2028	2028
1	Transferta e Pakushtëzuar	416,176	431,028	445,456
2	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	160,671	160,671	162,278
3	Transferta e Kushtëzuar	413,402	413,402	416,402
4	Të Ardhurat	192,610	193,646	194,077
TOTALI		1,182,859	1,198,747	1,218,213

3. Shpenzimet sipas programeve për vitet 2027-2028-2029

3.1 FUNKSIONI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

3.1.1 Nënfunzioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislativë, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme

Vështrim i përgjithshëm		
Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit;		
Kodi programit	Emri i Programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin; - Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësi, parqe qendrore automjete, zyra të printimit dhe IT etj; - Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë vetëqeverisjes

		vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë; • Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore; • Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit.
